V E N D I M
Nr. 364, datë 14.7.2000

PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE, QË SHKURTOHEN NGA ZBATIMI I MARRËVESHJES SË KONCESIONIT, PËR UZINËN E FERROKROMIT, ELBASAN DHE PËR MINIERAT E KROMIT PËRRENJAS DHE POJSKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999, "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive anonime "Albkrom"" dhe të ligjit nr.8590, datë 23.3.2000, "Për miratimin e marrëveshjes së koncensionit, të formës "BOT", për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan, dhe për minierat e kromit Përrenjas e Pojskë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane DARFO, s.p.a., për dhënien e disa stimujve dhe garancive për koncensionarin e kësaj marrëveshjeje", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësve që dalin të tepërt, si pasojë e zbatimit të marrëveshjes së koncensionit, për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan dhe për minierat e kromit Përrenjas dhe Pojskë, t'u jepet një shpërblim i barabartë me pagën e 2 (dy) viteve. Si pagë do të merret paga mujore bazë dhe vjetërsia në punë, që kanë patur në çastin e shkëputjes nga puna.

2. Fondet financiare prej 129 milionë lekësh, të nevojshme për dhënien e shpërblimit 398 punonjësve të Uzinës së Ferrokromit, Elbasan dhe të minierave të kromit Përrenjas dhe Pojskë, që do të trajtohen sipas këtij vendimi, të përballohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, nga fondet e dhëna prej koncensionarit dhe nga ato të krijuarat në zbatim të vendimit nr.416, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave.

3. Përfitojnë nga ky vendim ata punonjës të Uzinës së Ferrokromit, Elbasan dhe të minierave të kromit Përrenjas dhe Pojskë, të cilët kanë qenë të punësuar pranë këtyre njësive, pandërprerje, që nga 1.6.1999, e deri në periudhën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Shpërblimi i punonjësve që dalin të tepërt nga zbatimi i marrëveshjes së koncensionit për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan dhe për minierat e kromit Përrenjas dhe Pojskë, do të bëhet nga sh.a., "Albkrom", me 4 (katër) këste, të barabarta, në çdo 6 muaj. Kësti i parë do të jepet në muajin korrik 2000.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta